



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 67, Datë 11.04.2022

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SH.P.K., ME NR. 377, SERIA T17, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 434 dhe 434-1 prot., datë 08.04.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me nr. 377, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.07.2017”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 251 prot., datë 10.02.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në mbledhjen e bordit të datës 28.02.2022, u relatua relacioni nr. 263/3 prot., datë 21.02.2022, “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. me nr. 377, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 27.07.2017”.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 34, datë 28.02.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 377, Seria T17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, për arsye se nuk u vlerësua i mjaftueshëm dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria.
- Me shkresën nr. 251/1 prot., datë 02.03.2022, u njoftua shoqëria për vendimin e bordit të ERE-s dhe gjithashtu iu bë me dije se nëse do të paraqesë një aplikim të ri në respektim të kërkesave të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,

modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, duke respektuar kërkesat e saj për dokumentacionin e kërkuar, atëherë edhe pagesa për aplikim do të konsiderohet e vlefshme për aplikimin e ri.

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 251/2 prot., datë 18.03.2022, ka paraqitur “Plotësim i dokumentave ligjorë për rinovimin e licencave”, brenda afatit të përcaktuar më sipër dhe si e tillë dokumentacioni i dorëzuar në aplikimin fillestar dhe kryerja e pagesës së aplikimit konsiderohen të vlefshme.
- Në zbatim të përcaktimeve të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.
- Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë kryesisht dokumentacionin si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “d”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, Neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “c”. **Plotësuar.**

Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- gërma “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), **Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e gjykatës për administratorin e saj.**

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3:

- gërma “a” (vërtetim për shlyerjen e Tatim – Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore),
Vërtetimet janë plotësuar nga shoqëria, por duke qenë se kjo e fundit rezulton debitore ndaj Tatimit mbi Fitmin dhe Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (për të cilat ëhstë në proces ankimi), do të kërkohet informacion në lidhje me statusin e procesit të ankimit.
- gërma “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).
Shoqëria duhet të përcjellë në ERE në gjuhën shqipe letrën për shprehje të mbështetjes financiare nga shoqëria mëmë.

Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjië elektrike, Neni 9, pika 4.8:

- gërma “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti); **Shoqëria duhet të dokumentojë vërtetim gjendjeje llogarie të lëshuar nga institucionet financiare, për të provuar në ERE disponimin e vlerës që deklarohet për vënie në dispozicion për të dy veprimtaritë e licencuara. Po ashtu, duhet të specifikojë sa vlerë dedikon respektivisht për vijimin e secilës veprimtari, do të njoftohet shoqëria që t’i përcjellë në ERE brenda afateve.**
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 377, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjië elektrike që prej datës 27.07.2017, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119 me afat vlefshmërie deri më datë 27.07.2022.
- Në nenin 16, pika 1, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjië elektrike*”, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.
- Sikurse konstatohet shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj gati 5 (pesë muaj) përpara përfundimit të afatit të parashikuar në nenin 16, pika 2, ndaj si e tillë vlerësohet që në vendimin final të rinovimit do të specifikohet data e fillimit të vlefshmërisë së licencës.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjië elektrike në bazë të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjië elektrike*”, e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 377, Seria T17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjië elektrike, të miratuar me vendimin e bordit nr. 119, data 27.07.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 28.07.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI